



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 26, paragrafi 1. pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat, në Seancën e Përgjithshme, të mbajtur më datë 30 maj 2019, me shumicë votash, miratoi këtë:

MENDIM JURIDIK

- a) Dispozita e nenit 106 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ka përcaktuar, në mënyrë shprehimore, afatet kohore për ndjekje penale dhe në rast të kalimit të këtyre afateve nuk mund të ndërmerret ndjekja penale, kurse dispozita e nenit 106 par.2 të KPRK-së, ka specifikuar se afati i parashkrimit caktohet sipas dënimit më të rëndë.
- b) Afati i parashkrimit duhet të llogaritet sipas dënimit më të lartë të përcaktuar me atë vepër penale, ashtu që në rastet kur për veprën penale bazë, afati i parashkrimit të ndjekjes penale është më i shkurtër se te vepra penale e krimit të organizuar, afati i parashkrimit duhet të llogaritet sipas dënimit më të rëndë e që në këtë rast është vepra penale e krimit të organizuar.

A r s y e t i m

Disa gjyqtarë të Gjykatës Themelore në Pejë, me parashtrësën e datës 13.02.2018, nga Gjykata Supreme e Kosovës, kanë kërkuar dhënien e mendimit juridik në lidhje me llogaritjen e

afatit të parashkrimit relativ dhe absolut të ndjekjes penale, në rastet kur kemi të bëjmë me veprën penale krimi i organizuar në raport me veprën penale bazë, për të cilën udhëhiqet procedura penale, pasi që janë paraqitur dilema që afati i parashkrimit të ndjekjes penale të llogaritet sipas veprës bazë, e cila ka afat më të shkurtër të parashkrimit apo veprës penale krimi i organizuar, e cila ka afat më të gjatë të parashkrimit të ndjekjes penale.

Duke analizuar parashtresën për dhënien e mendimit juridik e në kontekst të dispozitës së nenit 106 par.2 të KPRK-së, ku shprehimisht është përcaktuar se afati i parashkrimit caktohet sipas dënimit më të rëndë. Ashtu që në rastin konkret dilema e parashtruar zgjidhet duke i marrë për bazë dënimet e përcaktuara për veprën penale krimi i organizuar në raport me veprën bazë dhe dispozitat e parashkrimit duhet që të llogariten duke ndjekur logjikën e dënimit më të lartë të përcaktuar për atë vepër penale. Në rastet kur te vepra penale bazë afati i parashkrimit të ndjekjes penale është më i shkurtër në raport me veprën penale krimi i organizuar, atëherë afati duhet të llogaritet sipas afatit më të gjatë e në rastin konkret sipas veprës penale të krimit të organizuar.

Andaj, mbi këtë bazë, Gjykata Supreme në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme të Kosovës, me shumicë votash, miratoi këtë mendim juridik.

(Mendim Juridik i miratuar në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme, mbajtur më 30 maj 2019)